



Banka e Shqipërisë
Departamenti i Politikës Monetare



Komisioni Evropian*

VROJTIMI I BESIMIT TË BIZNESIT DHE TË KONSUMATORIT


6 JANAR 2025

** Vrojtimet e besimit bashkëfinancohen nga Bashkimi Evropian dhe Banka e Shqipërisë. Duke filluar nga muaji maj i vitit 2016, ato kaluan në programin e Komisionit Evropian për harmonizimin e Vrojtimeve të Besimit.*

VROJTIMI I BESIMIT TË BIZNESIT DHE TË KONSUMATORIT

Treguesi i ndjesisë ekonomike (TNE) u tkurr me 3.8 pikë në muajin dhjetor. Megjithatë, niveli aktual i TNE-së qëndron me më shumë se 8 pikë përqindje mbi mesataren historike (Grafik 1). Rënia e TNE-së këtë muaj u ndikua nga dobësimi i të gjithë treguesve të besimit të sektorëve të biznesit. Rënia më e madhe u regjistrua në sektorët e ndërtimit dhe shërbimeve. Në një masë më të vogël ndikoi edhe rënia e besimit të konsumatorit (Grafik 2).

Grafik 1. Treguesi i ndjesisë ekonomike, TNE (mesatarja afatgjatë=100)




Burimi: Vrojtimi i Besimit të Biznesit dhe të Konsumatorit, Banka e Shqipërisë.

Treguesi i besimit të industrisë (TBI) ra me 1 pikë përqindje në muajin dhjetor, duke vijuar tendencën rënëse për të tretin muaj radhazi. Niveli i tij qëndron rreth 8.5 pikë përqindje mbi mesataren historike (Grafiku 2). Rënia e TBI-së u ndikua nga vlerësimet më pak pozitive të bizneseve për *prodhimin industrial* aktual. Pritjet për çmimet në të ardhmen janë rishikuar për lart krahasuar me muajin e kaluar, ashtu si edhe pritjet e bizneseve të këtij sektori për *punësimin* në të ardhmen (Tabelë 2, sektori i industrisë).

Treguesi i besimit në ndërtim (TBN) shënoi rënie me 5.5 pikë përqindje në dhjetor. Niveli i tij vijon të qëndrojë me rreth 22 pikë përqindjeje mbi mesataren historike (Grafik 2). Rënia e TBN-së u përcaktua si nga vlerësimet në rënie për *aktivitetin aktual ndërtues*, ashtu edhe nga ato për *kontratat porositëse*. Gjithashtu, pritjet për çmimet që do të vendosin ndërtuesit në të ardhmen kanë regjistruar rritje, ndërsa ato për punësimin paraqiten në përkeqësim të lehtë (Tabelë 2, sektori i ndërtimit).

Grafik 2. Treguesit e besimit sipas sektorëve*



Burimi: Vrojtimi i Besimit të Biznesit dhe të Konsumatorit, Banka e Shqipërisë.

Shënim: *Grafiku paraqet vlera të standardizuara për të korrigjuar ndryshimet ndërmjet mesatareve dhe devijimeve standarde të treguesve të besimit përkatës.

Treguesi i besimit në shërbime (TBSH) u tkurr me 5.5 pikë përqindje në dhjetor. Pavarësisht luhatjeve mujore, niveli i treguesit qëndron me 1.6 pikë përqindjeje mbi mesataren historike (Grafik 2). Në rënien e TBSH-së kontribuuan vlerësimet më pak optimiste të bizneseve për *ecurinë aktuale të aktivitetit të tyre*, dhe për *nivelin aktual të kërkesës*. Ndërkohë, pritet për nivelin e *punësimit* dhe ato për *ecurinë e çmimeve* në të ardhmen janë rishikuar për lart (Tabelë 2, sektori i shërbimeve).


Treguesi i besimit në tregti (TBT) u zvogëlua me 3.3 pikë përqindje në dhjetor, pas rritjes me 2.5 pikë përqindje në dy muajt e tjerë të këtij tremujori. Aktualisht, niveli i TBT-së qëndron rreth 1.1 pikë përqindje mbi mesataren historike (Grafik 2). Vlera aktuale e TBT-së u ndikua kryesisht nga vlerësimet në rënie të *ecurisë aktuale të biznesit* dhe pritjeve për *punësimin* në të ardhmen. Pritjet për çmimet në të ardhmen u vlerësuan në rritje (Tabelë 2, sektori i tregtisë).

Treguesi i besimit konsumator (TBK) regjistroi një rënie me 1.7 pikë përqindje. Ky nivel është 2.4 pikë përqindje mbi mesataren historike (Grafik 2). Konsumatorët vlerësuan me rënie të lehtë situatën ekonomike të vendit në të ardhmen. Vlerësimi i tyre për blerjet në shuma të mëdha, si aktuale dhe në të ardhmen, ra në muajin dhjetor (Tabelë 2, konsumatorët). Pritjet për nivelin e përgjithshëm të çmimeve në të ardhmen janë rishikuar për poshtë (Tabelë 2, konsumatorët).

Të dhënat me frekuencë tremujore¹ tregojnë se *gjendja financiare* e bizneseve u përmirësua lehtësisht në tremujorin e katërt, duke rezultuar si vlera më e lartë historike për sektorët e industrisë dhe ndërtimit. *Norma e shfrytëzimit të kapaciteteve* të tyre është rritur këtë tremujor në krahasim me tremujorin e mëparshëm. Të dy këta tregues qëndrojnë ndjeshëm mbi vlerat e mesatares historike përkatëse.


¹ Pyetjet mbi normën e shfrytëzimit të kapaciteteve dhe gjendjen financiare kanë frekuencë tremujore. Ato përfshihen në pyetësorët e bizneseve në muajt mars, qershor, shtator dhe dhjetor.

Grafik 3. Situata e biznesit sipas sektorëve, gjatë muajve të fundit




Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 4. Pritjet për situatën e biznesit gjatë muajve të ardhshëm




Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 5. Pritjet për papunësinë dhe çmimet e konsumatorëve për 12 muajt e ardhshëm



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 6. Blerjet në shumë të mëdha të konsumatorëve



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Tabelë 1. Treguesit e besimit sipas sektorëve*

	Vlerat			2024					Situata aktuale	
	min	mes	maks	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	Koniunkturale**	Strukturore***
Industri	-60.8	-8.7	5.7	1.4	3.7	0.9	-0.1	-1.1	↓	+
Ndërtim	-58.4	-19.9	8.2	3.2	4.0	0.7	5.3	-0.2	↓	++
Shërbime	-45.8	11.3	32.4	24.7	28.0	31.8	25.3	19.8	↓	+
Tregti	-32.6	1.1	17.3	13.4	10.2	11.0	12.7	9.5	↓	+
Konsumator	-40.8	-26.5	-16.3	-25.2	-25.1	-24.6	-22.5	-24.2	↓	+

Burimi: Vrojtimi i Besimit të Biznesit dhe të Konsumatorit, Banka e Shqipërisë.

*) Treguesit janë llogaritur nga balanca të rregulluara për sezonalitet. Balancat minimale, mesatare dhe maksimale, janë të llogaritura duke filluar nga muaji maj 2016.

**) Situata krahasuar me muajin e mëparshëm.

***) Situata për secilin tregues konsiderohet: shumë e kënaqshme (++) , kur treguesi është më shumë se 1 devijim standard më i lartë se mesatarja; e kënaqshme (+), kur treguesi është më pak se 1 devijim standard më i lartë se mesatarja; e pakënaqshme (-), kur treguesi është më pak se 1 devijim standard më i ulët se mesatarja; dhe shumë e pakënaqshme (-), kur treguesi është më shumë se 1 devijim standard më i ulët se mesatarja.

Tabelë 2. Balancat kryesore të sektorëve të ekonomisë (në pikë përqindje)

	2024								
	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor
INDUSTRIA									
Prodhimi gjatë tre muajve të kaluar (pyetja 1, komponent i TBI-së)	26.2	16.2	16.7	17.3	17.6	18.3	17.1	20.6	14.3
Kontratat porositëse (pyetja 2, komponent i TBI-së)	-7.7	-8.0	-8.9	-6.4	-1.6	-2.2	-6.2	-10.0	-8.8
Kontratat porositëse nga eksportet (pyetja 3, komponent i TBI-së)	-23.6	-15.5	-15.3	-16.8	-11.8	-5.2	-8.1	-10.9	-8.9
Inventari i produkteve të përfunduara (pyetja 4)	0.0	0.0	3.2	5.6	1.0	0.4	-7.2	-3.2	-0.3
Prodhimi pritje (pyetja 5)	24.2	28.4	28.6	31.2	30.4	29.1	23.7	34.6	32.0
Çmimet e produkteve pritje (pyetja 6)	10.7	6.4	8.9	10.3	14.8	15.7	14.1	9.6	12.2
Punësimi pritje (pyetja 7)	9.2	5.0	0.6	5.5	5.8	5.7	5.9	12.4	14.5
NDËRTIMI									
Aktiviteti ndërtues gjatë tre muajve të kaluar (pyetja 1, komponent i TBN-së)	20.0	18.5	18.2	21.9	27.7	30.4	24.2	31.7	26.3
Kontratat porositëse (pyetja 3, komponent i TBN-së)	-21.4	-20.6	-22.4	-20.1	-21.4	-22.5	-22.8	-21.2	-26.7
Punësimi pritje (pyetja 4)	16.1	12.2	14.2	17.1	16.9	18.7	17.5	18.8	17.6
Çmimet pritje (pyetja 5)	14.6	15.9	10.8	15.9	14.4	10.1	6.9	5.3	17.3
SHËRBIME									
Ecuria e biznesit gjatë tre muajve të kaluar (pyetja 1, komponent i TBSH-së)	32.0	33.7	25.6	28.4	25.7	27.4	31.8	27.3	20.8
Kërkesa gjatë tre muajve të kaluar (pyetja 2, komponent i TBSH-së)	30.6	31.2	30.8	30.2	23.6	28.6	31.8	23.4	18.9
Kërkesa pritje (pyetja 3)	33.9	36.0	25.6	32.9	31.0	30.5	28.7	34.0	34.2
Punësimi gjatë tre muajve të kaluar (pyetja 4)	5.9	10.0	12.9	15.3	8.1	18.0	13.4	12.2	9.4
Punësimi pritje (pyetja 5)	15.3	10.9	11.9	10.9	10.2	10.8	6.9	5.8	8.4
Çmimet pritje (pyetja 6)	9.0	6.6	9.1	3.9	10.2	9.5	9.0	8.7	12.9
TREGTIA									
Ecuria e biznesit gjatë tre muajve të kaluar (pyetja 1, komponent i TBT-së)	22.0	18.5	13.4	8.5	17.9	16.8	20.2	23.4	19.4
Gjendja e inventarëve (pyetja 2)	5.8	3.9	4.9	6.5	0.0	-1.0	-0.3	-2.9	0.8
Pritje për porositë në të ardhmen (pyetja 3)	25.2	29.3	23.8	22.8	21.9	26.0	22.4	22.8	15.9
Ecuria e biznesit pritje (pyetja 4)	31.8	33.2	23.3	19.2	26.8	34.8	28.3	27.0	21.2
Pritje për ecurinë e punësimit (pyetja 5, komponent i TBT-së)	4.3	7.9	2.9	2.1	8.9	3.6	1.8	2.0	-0.4
Pritje për ecurinë e çmimeve (pyetja 6)	0.0	3.2	7.1	4.7	7.2	-1.3	2.4	-3.6	9.0
KONSUMATORI									
Situata financiare aktuale (pyetja 1)	-4.7	-7.6	-8.8	-7.8	-6.9	-6.9	-5.9	-3.8	-5.4
Situata financiare pritje (pyetja 2, komponent i TBK-së)	7.6	4.2	2.9	2.3	3.0	2.9	2.5	4.3	4.4
Situata ekonomike aktuale (pyetja 3)	-10.1	-12.3	-14.0	-14.0	-12.9	-14.3	-11.3	-9.2	-10.6
Situata ekonomike pritje (pyetja 4, komponent i TBK-së)	5.2	2.5	1.1	1.4	3.4	2.0	2.2	5.2	3.5
Çmimet aktuale (pyetja 5)	30.3	33.3	32.3	29.7	29.0	24.5	28.0	24.2	22.7
Çmimet pritje (pyetja 6)	-9.0	-4.7	-2.1	-5.6	-5.5	-10.1	-9.9	-7.9	-10.1
Papunësia pritje (pyetja 7)	-3.5	-1.1	1.6	0.2	0.3	0.5	0.1	0.4	0.3
Blerjet e mëdha aktuale (pyetja 8, komponent i TBK-së)	-57.0	-63.1	-63.0	-62.2	-60.6	-60.7	-60.4	-58.0	-61.2
Blerjet e mëdha pritje (pyetja 9, komponent i TBK-së)	-43.1	-51.9	-49.2	-47.4	-46.6	-44.7	-42.9	-41.5	-43.5
Kursimi aktual (pyetja 10)	-40.4	-45.6	-45.8	-44.0	-43.9	-43.6	-41.6	-41.3	-41.0
Kursimi pritje (pyetja 11)	-37.1	-40.3	-38.4	-38.3	-36.5	-36.3	-39.0	-37.2	-35.4
Situata e të ardhurave dhe shpenzimeve (pyetja 12)	6.6	3.0	3.1	2.7	4.2	5.5	6.2	5.6	7.5

Burimi: Vrojtimi i Besimit të Biznesit dhe të Konsumatorit, Banka e Shqipërisë.

ANEKS

Shpjegime metodologjike

Balanca është treguesi që përdoret më shpesh për agregimin e të dhënave cilësore nga vërtetimet. Ajo llogaritet si diferencë midis përqindjes së përgjigjeve pozitive dhe përqindjes së përgjigjeve negative. Balanca shprehet në pikë përqindje.

Treguesi i Besimit (TB) ndërtohet për çdo sektor dhe llogaritet si mesatare e thjeshtë e balancave të rregulluara sezonalisht të treguesve, të cilat kanë korrelacionin më të lartë me serinë e referencës (serinë e të dhënave reale të ekonomisë).

Treguesi i Ndjesisë Ekonomike (TNE) ndërtohet duke u bazuar në të njëjtat balanca që përdoren për ndërtimin e TB-ve për secilin sektor (industri, ndërtim, shërbime, tregti dhe konsumatorë), duke synuar të kapë aktivitetin e ekonomisë në vend. Para agregimit të TNE-së, këto balanca standardizohen dhe peshohen.